Shqipëri – FV Lundrues KESH

Plani i Përfshirjes së Palëve të Interesit

Datë: 03.11.2020

Versioni: D

Referenca: 20g08D

Përgatitur për: EBRD

Projekt i zhvilluar nga : KESH

AKRONIME

BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
MM	Ministria përgjegjëse për Mjedisin
M&S	Mjedisor dhe Social
OPP	Oficer i Përfshirjes së Palëve të Interesit
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PVMS	Plan Veprimi Mjedisor dhe Social
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

PËRMBAJTJA

HYRJE 3

A. OBJEKTIVAT E PPPI 3

B. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT 3

B.1 PËRSE DUHET KY PROJEKT 3
B.2 MARRËVESHJET E PROJEKTIT 4

C. KUADRI LIGJOR DHE KËRKESAT 6

C.1 KUADRI LIGJOR PËR KËSHILLIMIN DHE INFORMIMIN E PUBLIKUT 6
C.2 KËRKESAT E BERZH 6

D. PËCAKTIMI DHE ANALIZA E PALËVE 7

E. PËRMBLEDHJE E PËRFSHIRJES SË DERISOTME TË PALËVE 8

E.1 AKTIVITETET PËR PËRFSHIRJEN E PALËVE NË VLERËSIMIN E POROSITUR 8
E.2 KËRKIMI NË MEDIA 9

F. SHPËRNDARJA E DOKUMENTAVE/INFORMACIONIT DHE AKTIVITETET E PËRFSHIRJES 11

G. MARRËVESHJET PËR PËRFSHIRJEN E PALËVE TË INTERESIT 13

G.1 ORGANIZIMI 13
G.2 MONITORIMI NDËRKOMBËTAR DHE RAPORTIMI 14
G.3 MEKANIZMI I ZGJIDHJES SË ANKIMIMIT 14

Hyrje

KESH – kompania shtetërore për prodhimin e energjisë po planifikon zbatimin e “Projektit Diellor Lundrues të Vaut të Dejës” (i njohur si "Projekti"), të lokalizuar në Rezervuarin e Vaut të Dejës, Shqipëri. Projekti kupton ndërtimin e një impianti fotovoltaik (FV) diellor lundures prej 12 MW dhe do të shoqërohet me infrastrukturën elektrike që pritet të lejojë lidhjen me nënstacionin e Hidrocentralit të Vaut të Dejës.

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po konsideron financimin e KESH për Projektin, që kategorizohet “B” në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale (PMS) 2019 të BERZH.

Ky dokument është Plani i Përfshirjes së Palëve të Interesit (PPPI) për Projektin.

A. Objektivat e PPPI

Synimi i përgjithshëm i PPPI është të sigurojë një qasje konsistente, gjithëpërfshirëse, koordinuese dhe të përshtatshme nga pikëpamja kulturore për këshillimin dhe informimin e publikut. Objektivat kryesorë të përfshirjes së palëve të interesit janë:

- Të sigurohet që të shpërndahet informacioni i përshtatshëm dhe në kohën e duhur tek palët e prekura të interesit ose palëve me mundësi për tu prekur ose që mund të kenë një interes mbi Projektin ose që kanë ndikim mbi Projektin. Këtyre grupeve duhet tu jepet hapësirë dhe mundësi për të shprehur shqetësimet dhe opinionet e tyre;
- Të vendoset një komunikim dhe bashkëpunim efektiv që lehtëson mbështetjen e gjerë nga publiku;
- Të sigurojë që komentet dhe shqetësimet të merren në kohën e duhur në mënyrë që ato të merren parasysh gjatë procesit të vendim-marrjes, dhe
- Të vendoset një mekanizëm ankimimi dhe ndërmjetësimi efektiv më qëllim kryesor zgjidhjen, mbylljen dhe uljen e numrit të rasteve që dërgohen në organet gjyqësore.

Ky PPPI përshkruan qasjen e përfshirjes së palëve të interesit, qasje që duhet ruajtur gjatë gjithë cklit të Projektit d.m.th. për para-ndërtimin, ndërtimin dhe aktivitetet e operimit.

PPPI ësht njëkohësisht një mjet që synon të sigurojë përputhshmërinë me Kërkesën e Performancës 10 të BERZH (sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale 2019), "Shpërndarja e Informacionit dhe Përfshirja e Palëve të Interesit ".

B. Përshkrimi i projektit

B.1 Përse duhet ky Projekt

Në përputhje me objektivat e përcaktuara nga Qeveria Shqiptare në Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2017-2030 dhe Planin Kombëtar të Konsoliduar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2019-2020 KESH sh.a. (KESH) po kërkon të rrisë dhe diversifikojë prodhimin dhe tregtimin e energjisë nga burimet e tij të rinovueshme, me qëllim rritjen e përfitimit ekonomik dhe konkurueshmërinë në tregun e brendshëm ose rajonal.

Projekti i impiantit lundrues të energjisë diellore në rezervuarin e Vaut të Dejes është planifikuar nga KESH me objektivat e mëposhtëm:

- Të mbajë dhe të forcojë pozicionin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri duke u përshtatur me ndryshimet në fushën e biznesit, në teknologjitë dhe mundësitë e financimit;
- Të prodhojë energji të pastër, ndërsa rrit performancën mjedisore dhe kapacitetin prodhues.

B.2 Marrëveshjet e projektit

Opsionet e shqyrtuara

Projekti është në Veri të Shqipërisë, afër qytetit Vau i Dejes. Vendndodhja e projektit gjendet në territorin e njësisë administrative Lac-Vau i Dejës (pjesë e Bashkisë së Vaut të Dejës), që shtrihet në Rajonin e Shkodrës. Zona e projektit ndodhet në një distancë prej 100 km nga Tirana dhe është lehtësisht e arritshme me makinë (90 min).

Për vendndodhjen e FV lundrues u shqyrtuan disa opsione. Opsioni 1, i gjendur pranë digës së Qyrsaqit, u konsiderua si opsioni i parapëlqyer, nëse do të ndërtohet në bashkërendim me Bashkinë e Vaut të Dejës në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me planet ekzistuese të bashkisë.

Figura 1 – Alternativat e vendndodhjeve tw projektit



Parametrat kryesorw tw projektit

Sipërfaqja e planifikuar për tu zënë nga FV lundrues do të jetë rreth 12 ha, që përfaqson 0.45% të sipërfaqes totale të rezervuarit në nivelin maksimal të ujit.

Prodhimi vjetor mesatar i energjisë së pritshme nga impianti FV është 17434 MWh. Energjia e prodhuar do të jetë më e lartë në muajt me kohëzgjatjen më të madhe të ditës (Prill-Shtator), por më efikas në muajt me temperatura më të ulta (Tetor-Mars).

Komponentët kyc të projektit përfshijnë;

- Impiantin FV lundrues të përbërë nga 35 840 panele diellore dhe 5 panele baterish fotovoltaike
- Inverterin, trnasformatorët dhe kabllot nënujore/nëntokësore që do të lidhin FV lundrues me rrjetin, në afërsi të nënstacionit ekzistues të Hidrocentralit të Vaut të Dejës.

Projekti shtrihet rreth 400 m (por jo i dukshëm) nga shtëpitë më të afërta në Vaun e Dejës. Fare pranë zonës së montimit të impiantit ndodhet një shtëpi dhe nje bar-kafe. Zona e montimit korrespondon me pontilin ekzistues dhe vinncin që përdorej për të shkarkuar mineralin e bakrit nga miniera e Komanit. Të gjithë komonentët e projektit do të vendosen në prona shtetërore, dhe blerja e tokës nuk do të jetë e nevojshme.

Figura 2 – Pontili ekzistues qw do tw pwrdoret pwr montimin, dhe gjiri ku do tw lundrojw impianti FV

Afatet kohore

Përgatitja e projektit pritet tw fillojë nw 2020 dhe të shtrihet në 2021, dhe do të përqëndrohet në përzgjedhjen përmes një procesi me konkurim ofertash të një kompanie që do të furnizojë dhe do të instalojë FV lundrues. Kontrata me këtë kompani është planifikuar të nënshkruhet në 2021.

Aktiviteti i ndërtimit do të zgjasë rreth 8 muaj. Kjo do të thotë se FV lundrues do të jetw gati dhe do të fillojë prodhimin në 2022.

C. Kuadri ligjor dhe kërkesat

Projekti do të zbatohet në përputhje më ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe në politikën mjedisore dhe sociale 2019 të BERZH.

C.1 Kuadri ligjor për këshillimin dhe informimin e publikut

Parimet kryesore të pjesëmarrjes publike jepen në Nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që shprehet se cdo person gëzon garancinë e së drejtës së informimit. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar gjithashtu Konventën e Aarhus në vitin 2000 (Ligji Nr. 8672, datë 26.10.2000, "Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për tu informuar, për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe për të pasur akses në drejtësi për cështjet e mjedisit"), që thekson të drejtën e publikut për informacion lidhur me mjedisin, të drejtën e publikut për të marr pjesë në vendim-marrjen mjedisore dhe të drejtën për të ngritur padi kur publiku ndjen se konsideratat për cështjet mjedisore janë të pamjaftueshme.

Në mënyrë më specifike, Projekti do të jetë subjekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis sipas legjislacionit shqiptar dhe do të jetë për këtë arsye, subjekt i këshllimeve publike sikurse kërkohet në përputhshmëri me kuadrin ligjor të mëposhtëm:

- Ligji Nr. 10440/2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis' amenduar me Ligjin Nr. 12/2015: Ky ligj ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim si dhe garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.
- Vendimi Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"; Përcakton fazat e informimit dhe të përfshirjes së publikut në procesin e VNM-së paraprake dhe të thelluar, mënyrën dhe afatet e dhënies së opinionit të publikut përpara vendim-marrjes; mënyrën dhe kohën e ankimimit të publikut për aktet, veprimet apo mosveprimet gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin paraprak dhe të thelluar të VNM-së.

Marrë parasysh situatën me pandeminë COVID-19 pandemic në kohën kur u përgatit ky PPPI, këshillimi pubik duhet gjithashtu të organizohet në përputhje me udhëzimet dhe protokollet që burojnë nga Ministria përgjegjëse për politikën Shëndetsore dhe Sociale në Shqipëri.

C.2 Kërkesat e BERZH

Përvec kërkesave të kuadrit ligjor shqiptar të përshkruar më sipër, projekti duhet të plotësojë kërkesat e stadarteve mjedisore dhe sociale të BERZH për përfshirjen e palëve të interesit.

Të gjitha projektet e financuara nga BERZH do të strukturohen për të përmbushur kërkesat e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH që përfshin dhjetë Kërkesa të Performancës

(KPs) për fusha kyçë të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale që duhet të plotësohen nga projektet, përfshirë KP10 Dhënia e Informacionit dhe Përfshirja e Palëve të Interesit. Përveç kësaj Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit (MPLLP) të BERZH, si një mjet i pavarur i mundësisë së fundit, synon të lehtësojë për Palët e Interesit, zgjidhjen e çështjeve sociale, mjedisore dhe të informimit të publikut, të ngritura nga personat e ndikuar (afektuar) nga Projekti si dhe organizatat e shoqërisë civile për projektet e financuara nga BERZH ose të përcaktojë nëse Banka ka zbatuar Politikën Mjedisore dhe Sociale (PMS) të saj dhe dispozitat specifike të Projektit lidhur me Politikën e Aksesit në Informacion; dhe të adresojë, aty ku është e mundur, çdo mospërputhje ekzistuese me këto politika, duke parandaluar ndërkaq mospërputhje të ardhshme nga Banka.

BERZH njeh rëndësinë e përfshirjes së palëve të interesit si një element thelbësor për praktikat e mira ndërkombëtare dhe përgjegjësitë e veta përkundrejt shoqërisë njerëzore. Kjo përfshirje është njëkohësisht një mënyrë për të përmirësuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale të projektit. Në vecanti, përfshirja efektive e komunitetit është thelbësore për menaxhimin e suksesshëm të rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe soiale të projektit. Përfshirja e publikut është pjesë qëndrore e arritjes së përfitimeve të shtuara të komunitetit nga një projekt i caktuar.

Përgatitja e këtij PPPI ka marrë parasysh kërkesat e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH (2019) dhe të Politikës dhe Direktivës së BERZH për Aksesin në Informacion (2019). Kwto politika janë organizuar përreth katër parimeve kryesore që janë marrë parasysh kur u përgatiti ky PPPI:

- Transparenca
- Llogari-dhënia
- Përgjegjësia e Klientit për Palët e Interesit të Prekura
- Mirëqeverisja

Në mënyrë më specifike, elementët e mëposhtëm të KP 10 janë pjesë thelbësore e këtij PPPI:

- Përcaktimi i palëve të interesit dhe analizimi i tyre
- Nevojat e Përfshirjes së Palëve të Interesit
- Parimin e “kuptueshmërsë” (dhënie e informacionit të vlefshëm dhe të kuptimtë)
- Vlefshmëria e mekanizmit të ankimimit

D. Pëcaktimi dhe Analiza e Palëve

Objektivi i përcaktimit të palëve është të vendosësh se cilët individë, grupe apo organizata mund të ndikohen nga projekti, direkt ose indirekt, pozitivisht ose negativisht, ose mund të jenë të interesuar për projektin dhe të përcaktojë llojet e informacionit që ata do të kishin nevojë përgjatë kohëzgjatjes së Projektit.

Palët e përcaktuara të interesit do të grupohen na kategoritë e mëposhtëme:

Palë të interesuara

Palë të interesuara jana ato palë që nuk ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Projekti, por mund të kenë interes në një fazë të caktuar të zhvillimit të tij. Këto palë duan përgjithësisht të përfshihen në Projekt, dhe të marrin informacion të vecantë që përbën interes për ta. Kjo kategori mbulon një numër të gjerë palësh, përfshirë:

- Administrata apo trupa shtetërorë kombëtar, rajonal ose lokal të papërfshira në mënyrë direkte në Projekt;
- Mediat kombëtare ose rajonale;
- Bizneset lokale qe mund të kthehen në furnizues të shërbimeve ose mallrave;
- Punë kërkuesit;
- Organizatat e shoqërisë civile të përfshira në programe sociale ose aktivitete për ruajtjen e mjedisit në këtë pjesë të Shqipërisë.

Palët mundësisht të prekura

Kjo kategori e njerëzve mund të ndikohet nga projekti dhe përfshin:

- Bashkinë e Vaut të Dejës (përputhshmëria e FV lundrues me planet e bashkisë);
- Banorë rezidentë dhe biznese që ndodhen pranë zonës së montimit (një shtëpi dhe një bar-kafe);
- Përdorues të ndërtesave teknike përballë zonës së montimit;
- Familje dhe përdorues të ndërtesave publike që ndodhen përgjatë rrugës së aksesit që do të përdoret për furnizim të kantierit.
- Përdorues të rezervuarit në zonën ku parashikohet montimi dhe instalimi: peshkatarë, notues, pronarë të varkave apo xhet-skive, shëtitës dhe turistë.

Palë vulnerabël (të brishta)

Në zonën e Projektit gjenden njerëz që njihen zyrtarisht si "vulnerabël" për shkak të kushteve të tyre personale (Legjislacioni shqiptar përcakton nocionin e vulerabilitetit social). Megjithatë, nuk është e pritshme që Projekti të ndikojë te grupet vulnerabël në mënyrë të qënësishme apo disproporcionale, për shkak të ndikimeve të kufizuara social të tij.

Ekziston një rrezik i vogël i mbetur për personat të cilët jetojnë përgjatë rrugë së aksesit dhe do të kenë vështirësi për tu përfshirë në informacion apo për të pasur akses në informacion (për shkak të moshës, aftësive të kufizuara, nivelit të edukimit, etnisë, statusit social ose ekonomik). Këta janë persona që do të konsiderohen “vulnerabël” në kontekstin e Projektit

E. Përmbledhje e përfshirjes së derisotme të palëve

E.1 Aktivitetet për përfshirjen e palëve në vlerësimin e porositur

Aktiivtetet e përfshrjes së palëve që u ndërmorën më 22-24 Qershor 2020 gjatë procesit të vlerësimit të porositur mjedisor dhe social, dhe përpara përgatitjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, përfshinë: një takim formal me Kryetarin e Bashkisë dhe përfaqësues të tjerë të Bashkisë së Vaut të Dejës, takime individuale me përfaqësues të tjerë të Bashkisë dhe të

palëve të interesuara në nivel rajonal, diskutime të fokusuara në grup me komunitetin vendor dhe këshilim/takime individual, intervista me komunitetin pranë zonës së studimit.

Ndërveprimi më qeverisjen vendore/bashknë e prekur ka ndodhur në disa raste dhe për dy arsye kryesore:

- Përfshirjen me qëllim paraqitjen e projektit dhe marrjen e mendimeve për projektin;
- Mbledhjen e inforacionit të rëndësishëm për Kushtet Bazë të burimeve mjedisore dhe sociale, përcaktimin e cështjeve shqetësuese të komuniteteve të prekura dhe përputhshmërisë me Planin e Përgjithshëm Vendor (ose Planin Territorial) të Bashkisë.

Një takim i organizuar nga KESH u zhvillua më 22 Qershor 2020 në zyrat e hidrocentralit të Vaut të Dejës. Kryetari i Bashkisë dhe përfaqësues të tjerë të Bashkisë (përfaqësues të zyrës së planifikimit të territorit, zyrës së investimeve publike), Drejtori i Hidrocentralit dhe përfaqësyes të KESH (ekipi mjedisor dhe teknik) morën pjesë në këtë takim ku u dha një paraqitje e shkurtër e projektit si dhe mundësitë dhe specifikimet teknike të tij.

Takimet e fokusuara në grup me palët e mundshme të prekura u kryen më 23 Qershor 2020 anë qytetin e Vaut të Dejës. Në takim morën pjesë 10 persona, përfshirë kryesisht banorë lokalë të papunë, si dhe 2 peshkatarë, 1 të punësuar në shtet dhe një person të vetë-punësuar. Individual meeting ëere also held on the field ëithin the small settlements around the reservoir.

Shqetësimet dhe çështjet kyçe kryesore të ngritura nga përfshirjae palëve u morën parasysh në përgatitjen e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Projektit, dhe lidheshin me:

- Një kundërshti të mundshme midis Planit të Zhvillimit të territorit të Bashkisë dhe Projektit;
- Rrezikun e humbjes së mënyrës së jetesës për peshkatarët dhe humbjen e vlerave estetike (impakti vizual);
- Cështje të sigurisë lidhur me lundrimin në korridorin lundrues;
- Ndikimet e mundshme në Turizëm dhe pejzazh dhe menaxhimi për të shmangur/ reduktuar ndikimet – pjesëmarrësit u informuan se KESH ishte e njohur me Planet Bashkiake, dhe po punontte më Bashkinë për të zgjedhur një opsion të parapëlqyer dhe të shmangte ndikimet negative;
- Shëndetin dhe sigurinë.

E.2 Kërkimi në media

Njohja dhe publiciteti i projektit

Projekti i Impiantit Fotovoltaik Lundrues në rezervuarin e HEC-it Vau i Dejës është reklamuar që prej vitit 2018, që përkon me fillimin e Projektit nga KESH-i dhe paraqitja e aplikimit të tij në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Turizmit. Lajmet në lidhje me aplikimin janë transmetuar përmes mediave masive, përfshirë stacionet televizive, portalet e lajmeve si dhe mediat sociale.

Në fundi të Majit 2018 projekti mori vëmendje maksimale dhe lidhej me lajmet se KESH po planifikon ndërtimin e një impiant fotovolatik lundrues në rezervuarin e Vaut të Dejës

Momenti i dytë kur projekti mori vëmendje të madhe ishte në fund të vitit 2018 dhe fillim të vitit 2019, dhe lidhej me informacionin që KESH kishte aplikuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në fillim të Dhjetorit 2018, për aprovimin në parim të një investimi për një impiant fotovoltaik lundrues me sipërfaqe rreth 11 ha dhe prodhim në një kapacitet prej 12.9 MWH.

Momenti i tretë dhe më i fundit i lajmeve mbi impiantin FV lundrues në Vau e Dejës ndodhi në fillim të shkurtit 2020 kur Enti Rregullator i Energjisë (ERE) mori një vendim në lidhje me çmimin e energjisë elektrike të prodhuar nga fotovoltaikët.

Vizibiliteti dhe reklamimi aktual i Rezervuarit të Vaut të Dejës

Rezervuari i Vau i Dejës është krijuar në fund të viteve 1960 si rezultat i ndërtimit të një Hidrocentrali (HEC) në lumin Drin. HEC-i Vau i Dejës është i pari ndër tre HEC-et e ndërtuara mbi lumin Drin, që përbëjnë burimin kryesor të prodhimit të energjisë elektrike për Shqipërinë.

Pothuajse i harruar në të kaluarën, rezervuari ka marrë një vëmendje të shtuar së fundmi ndaj turizmit, agroturizmit, si dhe trashëgimisë historike në lidhje me qendrat historike Dania, Sarda dhe Komani.

Kohët e fundit, në fund të Qershorit 2020, Televizioni Shtetëror Shqiptar ka transmetuar një dokumentar në lidhje me bashkinë e Vaut të Dejës dhe vlerat e saj turistike. Potenciali i rezervuarit për zhvillimin e turizmit është theksuar dhe informacioni është dhënë mbi iniciativat lokale të turizmit duke përfshirë ato të vendosura në Gjirin e Gomsiqe, Lisna-agroturizëm dhe ishullin Shurdhahu ose ish-qytetin mesjetar të Sarda si dhe Koman, me këtë të fundit të njohur nga arkeologët dhe historianët si një zonë shumë e rëndësishme e kulturës ilire.

Recent mass media neës have highlighted particularly the use of reservoir for navigation and tourism ëith Vau i Dejes municipality considering the potential for navigation through the lake as a very important asset for the economic development of the area.

Lajmet e fundit të mediave kanë theksuar në vecanti përdorimin e rezervuarit për lundrim dhe turizëm, me Bashkinë e Vaut të Dejës që e konsideron potencialin për lundrim përmes liqenit si një aset shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të zonës.

Figura 3 - Zonat turistike të Vaut të Dejës të përmendura nga media



F. Shpërndarja e dokumentave/informacionit dhe aktivitetet e përfshirjes

Tabela e mëposhtëme paraqet një përmbledhje të grupeve të interesit të përcaktuar deri më sot, qëllimin e përfshirjes dhe metodën e komunikimit që do të përdoret nga nxitësi i projektit (KESH) dhe kohën e përfshirjes. Plani duhet të rishikohet çdo vit dhe nëse është e nevojshme të përditësohet për të siguruar përfshirje transparente dhe të kuptimtë të palëve të interesit.

Tabela 1 – Aktivitetet për angazhimin e palëve të interesit

#	Palët e interesit	Tipii informacionit të shpërndarë / të përfshirë	Media	Koha (Pala përgjegjëse)
1	Familjet potencialisht të prekura dhe komunitetet fqinje: • Rezidentë të qytetit të Vaut të Dejës, fshatrave Gomsiqe e Poshtme dhe Sheldi • Familje që jetojnë, zotërojnë ose përdorin asetet pranë zonës së Projektit	Informacion i përgjithshëm mbi Projektin, dhe kontakti i kompanisë për më shumë informacion	Përgatitje një faqe ëeb të dedikuar mbi Projektin për FV lundrues (brenda faqes web të KESH ose në nj faqe të veçantë)	Përpara fillimit të projektit dhe përpara nënshkrimit të marrëveshjes financiare (Zotëruesi i PVMS i KESH)
2			Publikim i PJT (përmbledhjes jo-teknike), PVMS dhe PPPI në faqen web të Projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit	
3			Takim informativ publik në Vaun e Dejës (30' prezantim + 30' pyetje dhe përgjigje)	
4	Mas media rajonale	Informacion mbi Projektin	Njoftim për shtyp për PJT	Përpara fillimit të projektit (Zotëruesi i PVMS i KESH)
5	Bashkia e Vaut të Dejës	Marrëveshje midis KESH dhe Bashksë së Vaut të Dejës, në mënyrë që të sigurohet një integrim i mirë i impiantit FV lundrues me Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë. Marrëveshja duhet të përfshijë një përshkrim të qartë të kritereve të projektit që duhet të plotësohen për të siguruar përputhshmërinë e të dy projekteve, dhe një përshkrim të detyrimeve dhe angazhimeve përkatëse të KESH dhe Bashkisë për integrimin e dy projekteve.	Takim midis KESH dhe Bashkisë	Përpra aplikimit për leje ndërtimi dhe mbylljes së dizajnit të detajuar (Zotëruesi i PVMS i KESH)

#	Palët e interesit	Tipii informacionit të shpërndarë / të përfshirë	Media	Koha (Pala përgjegjëse)
6	Përdoruesit e rezervuarit	Ndarje e informacionit dhe rritje e ndërgjegjësimit mbi vlerat në ruajtje të biodiversitetit në rezervuarin e Vaut të Dejës.	Tabela informative që paraqesin speciet me interes për ruajtje në rezervuarin e Vaut të Dejës dhe statusin e konservimit/të ruajtjes së tyre: një tabelë në kantierin e ndërtimit tek zona e kalatës, dhe një tjetër në restorantin e madh në Gjirin e Gomsiqes (Restorant Perla). Tabelat informative duhet të dizenjohen për të qenë rezistente në kohë.	Tabelat të instalohen gjatë ndërtimit dhe të mirëmbahen gjatë fazës së operimit (Zotëruesi i PVMS i KESH)
7	Entitete rajonale me një lidhje apo interes në biodiversitetin e rezervuarit: Qytetarët e Vaut të Dejës, Agjensia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Agjensia Rajonale e Zonave tw Mbrojtura, Agjencia e Basenve Shkodër, prodhuesit e akuakulturës, OSHC-të të mbrojtjes së natyrës		Në takimin publik të planifikuar në qytetin e Vaut të Dejës për të prezantuar projektin e FV lundrues tek palët e interesit.	Përpra mbylljes së dizajnit të detajuar (Zotëruesi i PVMS i KESH)
8	Entitetet kombëtare të interesuara në ruajtjen e biodiversitetit: Ministria përgjegjëse për Mjedisin (MM) , Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombwtare e Zonave tw Mbrojtura (në varësi të MM), universitetet, OSHC-të e mbrojtjes së natyrës		Në Tiranë për Ministrinë përgjegjëse për Mjedisin (MM), Agjensinë Kombëtare të Mjedisit (në varësinë e MM), universitetet dhe OSHC për mbrojtjen e natyrës.	Përpra mbylljes së dizajnit të detajuar (Zotëruesi i PVMS i KESH)
9	Të gjitha palët e interesuara	Proces këshillimi publik sikurse kërkohet nga legjislacioni kombëtar	Takime publike – të përshtatura me situatën Covid-19	Sikurse kërkohet nga legjislacioni në fuqi (Zotëruesi i PVMS i KESH)
10		Raport i zbatimit t projektit: shpërndarje e një raporti M&S të thjeshtuar që përmbledh: monitorimin e biodiversitetit; statistikat M&S, ankimimet.	Në faqen web të dedikuar për projektin e FV lundrues	I përvitshëm (Zotëruesi i PVMS i KESH)

#	Palët e interesit	Tipii informacionit të shpërndarë / të përfshirë	Media	Koha (Pala përgjegjëse)
11	Palët vulnerabël në afërsi të zonës së projektit (Femra kryefamiljare; njerëz të moshuar; Persona me aftësi të kufizuara; etj..)	Nevoja për informacione/media specifike	Takime derë më derë dhe identifikim i peronave vulnerabël që jetojnë përgjatë rrugës nga qendra e Vaut të Dejës në zonën e montimit të impiantit. Identifikim i veprimeve të vecanta shtesë të kërkuara për të zbutur rreziqet e gjeneruara nga Projekti tek palët vulnerabël. Takim i përjavshëm me familjen dhe bar-kafen fare pranë zonës së monitimit të FV lundrues	At the beginning of project construction (Njësia Sociale – Mjedisore e KESH)
12	Dhënësit e mundshëm të furnizimeve dhe shërbimeve	Informacion mbi Prokurimet e Projektit, dhe kontakti i kompanisë për më shumë informacion	Informacion në faqen web të projektit për furnizuesit e mundshëm mbi Prokurimet e Projektit	Gjatë ndërtimit (Zotëruesi i PVMS i KESH)
13	Punëkërkuesit	Informacion mbi mundësitë për punësim	Informacioni mbi mundësitë e punësimt i njoftuar në faqen web të Projektit	Gjatë ndërtimit (Zotëruesi i PVMS i KESH)
14	Policia rrugore	Shqetësime të planifikuara të trafikut ose të karvaneve me ngarkesa të rënda të makinerive (nëse)	Korrespondencë formale dhe takime	5 ditë përpara shqetësimit (Njësia Sociale – Mjedisoree KESH)

G. Marrëveshjet për përfshirjen e palëve të interesit

G.1 Organizimi

KESH do të emërojë një Oficer të Përfshirjes së Palëve (OPP) për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm dhe sistematik me palët e interesuara të projektit.

Pozicioni i OPP nuk është i nevojshëm të jetë me kohë të plotë, por përgjegjësia duhet ti jepet, për shembull të njëjtit person të ngarkuar me zbatimin e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS). Ai/ajo do të përditësojë rregullisht këtë PPPI dhe do të japë informacion, mbledhë përgjigjet dhe mendimet dhe do ti përgjigjet palëve të interesit se si janë marrë parasysh mendimet e dhëna. Gjithashtu OPP do të japë përgjigje për komunikimet e tjera (me email, telefon apo takime).

OPP do të organizojë dhe bashkërendojë përgatitjen e faqes web si dhe të mjeteve e komunikimit të Projektit. Detajet e kontaktit profesional të OPP do të jepen në PJT

OPP do të përcaktojë pikat e kontaktit në gazetat, radiot, TV më të njohura, do tu japë atyre informacion fillestar mbi projektin si dhe do ti përfshijë në listën e emaileve për ngjarjet e ardhshme.

OPP do të vendosë kontake më email me përfaqësuesit e OSHC-ve mjedisore dhe sociale që do të shprehin interes për projektin, do ti furnizojë me informacion fillestar mbi projektin dhe do ti përfshijë në listën e emaileve.

OPP do të kryejë funksionet e mëposhtëme:

- Të sigurojë zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në Tabelën 1
- Monitorim vjetor të efektivitetit të planit të përfshirjes së palëve të interesit dhe të mekanizmit të ankimimit dhe ti përditësojë nëse është e nevojshme;
- Monitorim dhe përditësim të faqes web;
- Pjesëmarrje në zgjidhjen e ankimimeve;
- Ndihmesë në përgatitjen e raportit vjetor dhe në zbatimin e planit mjedisor dhe social.

G.2 Monitorimi ndërkombëtar dhe raportimi

OPP do të mbajë bazën e të dhënave mbi përfshirjen e palëve, në një format të thjeshtë në trajtë tabele:

Tabela 2 – Baza e të dhënave mbi përfshirjen e palëve

#	Emri / Adresa	Pyetja /Ankimi	Metoda e përgjigjes	Përgjigja	Statusi	A është përgjigja e kënaqshme
Të dhëna 01					Rdata e përgjigjes, mbyllja e cështjes etc.	po, jo
Të dhëna 02						

OPP do të organizojë dhe monitorojë gjithashtu efektivitetin e zbatimit të PPPI dhe do të dorëzojë te KESh raportime tre-mujore.

Raportimet tre-mujore do të përfshijnë:

- Përshkrimin e aksioneve të Planit të Përfshirjes së Palëve të Interesit të ndërmarrë gjatë periudhës së raportimit, me reference ndaj PPPI;
- Statistika për periudhë e raportimit (duke përdorur bazën e të dhënave):
  - Numrin e vizitave në faqen web
  - Numrin e shqetësimeve/çështjeve të ngritura me telefon, email ose direkt në ambientet e kompanisë.
  - Temat kryesore të shqetësimeve
  - Numrin e ankimimeve
  - Temat kryesore të ankimimit

G.3 Mekanizmi i zgjidhjes së ankimimit

Objektivi i mekanizmit të zgjidhjes së ankimimeve është ti japi zgjidhje problemeve në kohën e duhur dhe në rrugë miqësore, në mënyrë që të shmangë proceset gjyqësore konsumuese në kohë dhe burime. Mekanizmi është i hapur për cdo qytetar ose banor.

OPP do të regjistrojë të gjitha ankimimet në bazën e të dhënave mbi përfshirjen e palëve (Tabela 2). Baza e të dhënav i shërben kontrollit të procesit të trajtimit të ankimimit. Ky mekanizëm nuk kufizon të drejtat e publikut për të përdorur rrugët konvencionale të ankimimit apo sistemin gjyqësor përkatës.

Në varësi të natyrës dhe statusit të shqetësimit/cështjes dhe ankimimit, OPP do të vendosë nëse do të duhet të trajtohet si një ankimim, sikurse në diagramën më poshtë.

Diagrama e ankimimi që do të përdoret për periudhën e ndërtimit jepet në figurën më poshtë. Pas ndërtimit, ankimimet do të menaxhohen nëpërmjet mekanizmit të ankimimit të korporatës KESH.

Figure 4 - Grievance mechanism



Annex 1 Formulari i Ankimimit

GRIEVANCE FORM Reference No:	
Full Name Note: *you can remain anonymous if you prefer or request not to disclose your identity to the third parties without your consent*	My first name _____ My last name _____ ☐ I wish to raise my grievance anonymously☐ ☐ I request not to disclose my identity without my consent
Contact Information Please mark how you wish to be contacted (mail, telephone, e-mail).	By Post: Please provide mailing address: _____ _____ _____ By Telephone: _____ By E-mail _____
Preferred Language for communication	Albanian English Other:
Description of Incident or Grievance:	What happened? Where did it happen? Who did it happen to? What is the result of the problem?
Date of Incident/Grievance	
	One-time incident/grievance (date _____) Happened more than once (how many times? _____) On-going (currently experiencing problem)
What would you like to see happen to resolve the problem?	

Signature: Date:

Please return this form to the SEO [name and contact details]